



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0828

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim- Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Isa Hasni -Anëtar të panelit shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE HM Home SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 07.11.2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e datës 10.09.2024, me nr. 2024/0828 e Operatorit Ekonomik (OE) HM Home SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Vërtetohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimin të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas nenit 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.08.2024 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim.

Me 03.09.2024 OE HM Home SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 12.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE HM Home SH.P.K., me numër protokollit 2024/0832 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues HM Home SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Neni 7 i LPP-së;Neni 27 i LPP-së;Neni 28 i LPP-së;Neni 51 i LPP-s; Neni 69 i LPP-së Neni 4 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik;Neni 17 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik; Neni 24 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik; Neni 25 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe dispozitat: Neni 61 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik; Neni 63 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues, komuna e Prishtinës, ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së - Ritender", me nr. të prokurimit: 616-24-8683-1-1-1 dhe nr. të brendshëm: 616-24-140-1-1-1. Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë se Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit, të cilat haptas favorizojnë grupin e operatorëve ekonomikë NSHT “NERA MED”, “MADEKOS” SHPK dhe WOOD CORPORATION L.L.C., pasi që kërkesat nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë.

Autoriteti kontraktues, në pikën 4 tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ka kërkuar:

4. Kopja e Licencës së AKPPM-së si qarkullues me shumicë të pajisjeve medicinale, e cila është në kundërshtim me natyrën e prokurimit në fjalë, pasi që mbi 90% e artikujve kanë të bëjnë me inventar për zyre. Andaj, kjo licencë, e cila është për barna dhe pajisje mjekësore, nuk ka të bëjë fare me natyrën e prokurimit në fjalë. Procedura e prokurimit në fjalë është publikuar edhe më parë nga AK i njëjtë dhe është anuluar, pasi kishte shpërblyer me kontratë grupin e O.E. të lartcekur, edhe përkundër se kishin paraqitur tender të papërgjegjshëm. Edhe me rastin e publikimit për herë të parë të kësaj procedure, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim të kriterëve dhe kemi ofruar prova të mjaftueshme që kriteret janë përgatitur ekstra për të favorizuar grupin e O.E. NSHT “NERA MED”, “MADEKOS” SHPK dhe WOOD CORPORATION L.L.C. Pretendimet tona janë vërtetuar, pasi që Autoriteti Kontraktues kishte shpërblyer me kontratë grupin e O.E. për të cilin ne kishim ngritur dyshimin.

Autoriteti Kontraktues ka paraqitur specifika për të cilat ka cekur se dallimi në dimensione lejohet deri në $\pm 5\%$, gjë e cila është një përqindje e vogël, pasi që janë kërkuar artikuj të cilët janë specifikë. Andaj, kërkojmë që dallimi të lejohet deri në $\pm 10\%$ në mënyrë që të mundësohet sa më shumë pjesëmarrja e O.E. dhe prezantimi i markave të ndryshme.

Përndryshe, kjo qartazi paraqet shkelje dhe është në kundërshtim të plotë me Nenin 28 të LPP-së për specifikime teknike. Organi Shqyrtues i prokurimit, në vendimin OSHP: 2023/0843, në të cilin kishte shqyrtuar pretendimet e një O.E., ndër të tjera kishte konstatuar se Paneli Shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë përmirësimet në dosjen e tenderit, duke lejuar një tolerancë të dimensioneve dhe peshave të inventarit.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vendosur kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese dhe jo relevante me natyrën e prokurimit në fjalë. Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesional, kapaciteti teknik dhe profesional, në pikën nr. 6 ka paraqitur kërkesën:

6. Kopja e Autorizimit me të dhënat e tenderit, Kopja e Katalogut Broshurave të prodhuesit për pozitat 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111. Kërkesa që për pozitat e lartcekura të paraqitet autorizimi i prodhuesit apo dilerit të autorizuar e kufizon në masë të madhe konkurrencën, pasi që e drejton tregun për furnizim të këtyre materialeve vetëm nga një prodhues i parazgjedhur. Kjo paraqet edhe shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-së, pasi që diskriminohen prodhuesit e tjerë si dhe ofertuesit që planifikojnë të marrin pjesë në këtë tender. Prandaj, kërkesa që O.E. të paraqesin kopjen e autorizimit me të dhënat e tenderit dhe kopjen e katalogut broshurave të prodhuesit për pozitat e lartpërmendura duhet të hiqet, pasi që, siç kemi cekur, kjo kërkesë e favorizon vetëm grupin e caktuar më lart dhe diskrimon prodhuesit apo O.E. të tjerë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues ka paraqitur edhe kërkesat për certifikatat ISO 9001:2015 dhe 13485:2016 të noterizuara, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e prokurimit në fjalë, pasi që certifikata 13485 ka të bëjë me projektimin për tu përdorur nga organizatat e përfshira në projektimin dhe servisimin e pajisjeve mjekësore. Pra, edhe ky kriter haptas është vendosur për grupin e operatorëve ekonomikë të lartcekur.

Autoriteti Kontraktues, pas parashtrimit të kërkesës tonë për rishqyrtim të kriterëve diskriminuese, duke mos e shqyrtuar fare kërkesën tonë për rishqyrtim, si dhe duke mos e pezulluar procedurën e prokurimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitave me të cilat rregullohet procedura e shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim. Në nenin 61, paragrafi 61.1 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik është paraparë që: Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim

automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe, në këtë rast, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftojë me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Gjithashtu, në nenin 61, paragrafi 61.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik është paraparë që: Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditëve pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara, mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar fare kërkesën tonë, andaj konsiderojmë se është shkelur dispozita në fjalë.

Gjithashtu, në nenin 63, paragrafi 63.2 është përcaktuar që Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistemin e prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerr vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operator Ekonomik ka të drejtë që të parashtojë një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) ditëve pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim.

Duke mos e shqyrtuar fare kërkesën tonë për rishqyrtim, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka bërë shkeljen e paraparë në Nenin 97. Shkeljet e rënda, paragrafi 97.1, shkelje të rënda konsiderohen: e. Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP. Andaj, në përputhje me nenin 91, paragrafi 91.1, pika b), kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të iniciojë procedurën për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit në Komunën e Prishtinës.

Duke u bazuar në faktet dhe provat e lartëcekura, kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ankesën tonë si të bazuar dhe të detyrojë Autoritetin Kontraktues, Komuna e Prishtinës, që të heqë kriteret diskriminuese të cekura më lart.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se, sipas nenit 10, paragrafi 10.3 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP), është përcaktuar se njësi kërkuese, ndër të tjera, ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11, paragrafi 11.3 të RRPP, përcaktohet se zyrtari i prokurimit, në bashkëpunim me njësinë kërkuese, i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast, zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese.

Lidhur me pretendimet ankimore, duhet cekur se kërkesa për licencë të AKPPM, si dhe kërkesat për certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO 13485:2016, secila prej tyre veçmas dhe të gjitha së bashku, janë absolutisht të domosdoshme për të garantuar standardin e nevojshëm të cilësisë që nevojitet për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit. Prandaj, edhe këto pretendime ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Lidhur me pretendimet se kërkesat e Dokumentit të Tenderit (DT) për autorizim të prodhuesit/dilerit, së bashku me katalogët/broshurat, nuk është aspak e saktë pretendimi që këto kërkesa janë në kundërshtim me nenin 7 të LPP apo me ndonjë dispozitë tjetër ligjore në fuqi. Përkundrazi, këto kërkesa janë absolutisht kërkesat më themelore të mundshme, duke marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj, këto pretendime janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0828, ndërsa me datë 17.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0828 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues analizimin e teresishem të kriterëve të DT në cilësinë e ekspertit shqyrtues kërkoj nga ana e PSH OSHP që të aprovoj pjesërisht të bazuar ankesën e OE dhe të kërkohet nga ana e AK korrigjimi i kriterëve në pikat e FDT sipas pikave dhe sqarimeve të cekura në këtë ekspertizë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, gjithashtu OE nuk është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE HM Home SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0828 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetit të prokurimit, i cili ka të bëjë me furnizimin me inventar për nevojat e KPSH, konstatoj se kërkesa e cila është parashtruar në Dokumentin e Tenderit (FDT) në pikën nr. 4, për kopjen e licencës së AKPPM-së si qarkullues me shumicë të pajisjeve medicinale, nuk ka lidhje me natyrën e prokurimit. E njëjta licencë shërben në rastet e furnizimeve të pajisjeve medicinale, dhe kërkesa e saj në këtë aktivitet të prokurimit do të ishte në kundërshtim me Nenin 1, Nenin 7, Nenin 51 dhe Nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Gjithashtu, kjo kërkesë mund të jetë diskriminuese për operatorët e tjerë furnizues të inventarëve. Bazuar në këto konstatime, vlerësoj se pretendimi ankimor është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Është përgjegjësi e autoriteteve kontraktuese që të përcaktojnë apo hartojnë specifikimet teknike sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me LPP, Neni 28. Autoriteti Kontraktues në specifikimin teknik ka lejuar tolerancën +/- 5%. Si ekspert shqyrtues, nuk mund të konstatoj apo të konkludoj se nuk ka tolerancë. Përcaktimi i tolerancës i takon Autoritetit Kontraktues, pasi ata e përcaktojnë atë sipas nevojave të tyre, të cilat mund të kenë dhe ju lejohet. Në cilësinë time si ekspert shqyrtues, nuk mendoj se kam të drejtë të obligoj një tolerancë deri në +/- 10%. Këtë çështje mund ta kërkojnë operatorët ekonomikë edhe gjatë fazës së tenderimit me anë të kërkesave për sqarime dhe mbetet në diskrecionin absolut të Autoritetit Kontraktues të vendosë mbi këtë.

Konstatimi i tretë (III): Autoriteti Kontraktues në FDT ka kërkuar autorizimin e prodhuesit ose dilerit të autorizuar, si dhe katalogun/broshurën e prodhuesit për pozitat 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111 (për këto pozita lejohet ofertimi me dimensione +/- 5%).

Në cilësinë e ekspertit shqyrtues, konstatoj se kërkesa për autorizim është në përputhje me Nenin 66 të LPP-së dhe Nenin 44 pika 44.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues nuk është kufizuar vetëm në autorizimin e prodhuesit, por ka përfshirë edhe dilerin, prandaj konstatoj se pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Sipas nenit 44.4, AK gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit, përveç anekseve standarde pjesë të Dosjes së Tenderit, mund të shtojë anekse të tjera si Formularin për themelimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë, Formularin për Autorizimin nga Prodhuesi, Formularin për listën e projekteve të realizuara, etj.

Po ashtu, kërkesa për katalogun ose broshurat për pozitat e kërkuara konsiderohet në përputhje me LPP-në.

Konstatimi i katërt (IV): Kërkesa e AK në FDT për ISO 9001:2015 është në përputhje me Nenin 70 dhe interpretimin e KRPP-së të datës 09.06.2023 (ISO 9001:2015 është për menaxhimin e cilësisë dhe është një standard gjeneral).

Ndërsa ISO 13485:2016 është për pajisjet mjekësore. Duke pasur parasysh natyrën e prokurimit, e cila lidhet me furnizimin me inventar dhe jo me furnizimin me pajisje mjekësore, konsideroj se kjo ISO duhet të largohet nga kërkesa e FDT-së, prandaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Sipas interpretimit të KRPP-së, në të shumtën e rasteve, autoritetet kontraktuese në dokumentet e tenderit (Dosja e tenderit dhe Njoftimi për Kontratë) po vendosin kërkesa dhe kriterë diskriminues duke specifikuar dëshmi dhe certifikata të ndryshme në emër të cilësisë, pa pasur ndonjë lidhshmëri ndërmjet lëndës së aktivitetit të prokurimit (objektit të kontratës) dhe cilësisë së synuar. Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 24 të LPP-së, “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Gjatë ekzekutimit të aktiviteve të prokurimit, autoriteti kontraktues është i obliguar që në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit t'i respektojë dhe zbatojë parimet themelore të prokurimit të përcaktuara me këtë ligj. Sipas paragrafin 2 të nenit 7 të LPP-së, “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon

konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomikë”.

Po ashtu, me paragrafin 3 të këtij neni rreptësisht i ndalohej autoritetit kontraktues, përveç tjerash, që në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për kontratë të vendosë kërkesa ose kritere të përzgjedhjes që në një mënyrë kanë për qëllim të favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë që një OE duhet t'i plotësojë për t'u konsideruar i kualifikuar (i përgjegjshëm). “Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomikë që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për t'i përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim”.

Ndërsa paragrafi 3 i nenit 51 të LPP-së në mënyrë rigoroze përcakton se, “Të gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet dhe informacionet e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse”.

Në vazhdim, sipas paragrafin 2.5 të nenit 69 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të kërkojë, “Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse”.

Bazuar në këtë, KRPP rekomandon zyrtarët e prokurimit që, me rastin e vendosjes së kriterëve apo kërkesave kualifikuese, të kenë parasysh që mund të kërkojnë vetëm ato certifikata që janë ngushtë të lidhura me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit.

Konstatimi i pestë (V): Gjatë shqyrtimit të dokumentacioneve të procedurës në sistemin e e-prokurimit, kam vërejtur se në kërkesën për rishqyrtim është publikuar edhe vendimi i AK-së me datën 12.09.2024, në orën 13:14, si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim. Bazuar në këtë, konstatoj se AK-ja është përgjigjur ndaj pretendimeve ankimore të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, prandaj këtë pretendim e konsideroj të pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues HM Home SH.P.K., dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit

ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues HM Home SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara dhe kërkohet nga ana e AK korigjimi i kritereve në pikat e FDT - së.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës nuk i mbeshket rekomandimet e ekspertit shqyrtues, mirpo ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. PSH konsideron se eksperti shqyrtues në disa konstatime të tij nuk është treguar profesionale por ka japur mendimet e tij, pa asnjë provë, argument apo elaborim se si kërkesat e DT mund të jenë diskriminuese. Sa i përket Përgjegjesë së ekspertit shqyrtues ne pretendimin ankimore nr.1, i cili citon: ‘‘Duke pasur parasysh natyren e aktivitetit te prokurimit i cili ka të bëjë me Furnizim me inventar për nevojat e KPSH, konstatoj se kërkesa e cila është kërkuar ne FDT ne pikën nr.4 , Kopja e Liqences se AKPPM-së si qarkullues me shumicë të pajisjeve medicinale nuk ka te bëjë me natyren e prokurimit, e njejta licencë shërben ne rastet e furnizimeve te pasijeve medicinale dhe kerkesa e saj ne këtë aktivitet te prokurimit do ti ishte ne kundërshtim me Nenin 1, Nenin 7, Nenin 51 dhe Nenin 69 te LPP, dhe e njeta mundet qe te jetë diskriminuese për operatorët tjerë furnizues te inventareve , eksperti shqyrtues eshte dashut te anlizon ne tersi kete procedur perfshier edhe listen (pershkrimin e çmimeve -specifikacionet teknike te detyruara) se çfarë produktesh janë kërkuar nga AK-ja , ngase nga përshkrimi i çmimeve mund të vërehet shumë qartë se këto furnizime do të jenë inventar për produkte medicinale dhe shërbime medicinale si psh tek artikulli nr 4.58 (Frigoriferit Medicinal per reagjenta dhe barna, poz 4.50 Krevat Elektrik spitalor me tri funksione; poz 4.54 ; shtratit ekzaminues; 4.27; 4.26 ;4.14 etj) , e që dallojnë nga furnizimet me inventare të zakonshme (ormana , tavolina , karrika etj).

Paneli Shqyrtues referuar raportit te eksperti shqyrtues konstaton se ekspertit shqyrtues nuk ka ofruar ndonjë provë apo argument rreth diskriminimit dhe nuk ka ofruar ndonje fakte duke hulumtuar tregun se sa kompani, dhe cilat kompani mund të operojnë në tregun e vendit tonë, sepse nëse fillohet me zbutje të kritereve, vetëm e vetëm me ju përshtat një OE i cili nuk mund të bëjë furnizime të inventareve të tilla që lidhen me ato medicinale atëherë, konsiderohet qe mund ta rrezikojmë një furnizim sipas nevojave të AK-së. Po ashtu, eksperti shqyrtues ka thënë se kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me nenin Nenin 1, Nenin 7, Nenin 51 dhe Nenin 69 te LPP, dhe e njëjta mundet qe te jetë diskriminuese për operatorët tjerë furnizues te inventareve.

Mirpo duke e potencuar faktin qe ne kete procedur per vendosjen e kritereve ka parashkruar ankes në OSHP vetë ky OE, ku ne treg jane te njohura shum fabrika te mobileve dhe pjesmarres ne procedura dhe poashtu, edhe nëse analizohen edhe furnizuesit e tjerë të inventareve të cilët ofertojnë zakonisht në tendere në autoritete kontraktuese, asnjëri prej tyre nuk ka paraqitur ankesë për këto kërkesa e qe mund të jetë një prej argumenteve se kërkesat e tilla nuk mund të konsiderohet si diskriminuese.

Lidhur me pergjigjen e ekspertit shqyrtues ne pretendimin ankimore nr.4, i cili citon: lidhur me ISO 13485: 2016 është për Paisjet mjekësore), dhe duke pasur parasysh natyren e prokurimit qe kemi te bëjm me Furnizim me inventar dhe jo furnizim me paisje mjekesore andaj bazuar ne këtë dhe interpretimin e KRPP-së kjo ISO duhet qe te largohet nga kerkesa e FDT. PSH nuk pajtohem me konstatim njëjtë sikur më lartë ngase, eksperti shqyrtues vetëm e ka lexuar titullin e aktivitetit të prokurimit, pa hyrë fare në thelb të këtij aktiviteti dhe pa e shikuar fare edhe përshkrimin e këtij aktiviteti se me çfarë produktesh do të furnizohet AK, ngase nga përshkrimi i

çmimeve siç janë potencuar më lartë mund të vërehet, janë evidente se këto furnizime do të jenë inventar për produkte medicinale dhe shërbime medicinale për nevojat e KPSH (Institucionet shëndetësore siç përkrahën edhe në DNPDF të AK-se në këtë procedur), e që dallojnë nga furnizimet me inventare të zakonshme. Lidhur me këtë, Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuese e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish kërkesat e DT, bazuar në gjetjet e ekspertit shqyrtues. Ku, Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të refuzojë raportin e ekspertit.

Si rrjedhojë, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, ka vendosur që të lë në fuqi njoftimin për kontratë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe AK të vazhdojë tutje me aktivitetin e prokurimit, me çrast secili OE ka mundësi të hulumtoj tregun të gjej prodhues dhe të ofertojë konform specifikave të AK të vendosura për këto pajisje.

Paneli Shqyrtues konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e produkteve që plotësojnë nevojat adekuate të tyre, si dhe pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP-së, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Andaj, AK është përgjegjëse edhe për hartim të DT, sipas nenit 27 dhe 28 të LPP.

Paneli Shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërisht të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit në Gjykatën Komerciale/ Departamentit për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - HM Home SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: